



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



**KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 pika d, nenin 51 paragrafet 1 dhe 3, neni 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28), Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, neni 6 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.05/L-20 për Barazi Gjinore, neni 40 i Statutit të Komunës së Dragashit i dt. 30.01.2008, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, në mbledhjen e mbajtur më 30.12.2021 miratohet ky:

**V E N D I M**

**PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË E FINANCA**

**I**

**THEMELOHET** Komiteti për Politikë e Financa i Kuvendit të Komunës së Dragashit, në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarë:

1. **z. Uran Halimi, kryesues (VV),**
2. **z. Xhemile Misinaj, anëtare (PDK),**
3. **z. Artan Loshaj, anëtar (PDK),**
4. **z. Xhyllferie Batjari – Beqiri, anëtare (LDK),**
5. **z. Arjeta Skeraj, anëtar (LDK)**
6. **z. Munir Jonuzi, anëtar (VAKAT),**
7. **z. Fejsal Halilović, anëtar (JGP)**

**II**

Kompensimi për anëtarët e këtij Komiteti do të bëhet do të bëhet në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për pagesën e stafit politik në komuna 16/2008.

**III**

Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfundon me përfundimin e mandatit aktual të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, apo nga ndonjë vendim tjetër i Kuvendit të Komunës.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

*U dërgohet:*

- Anëtarëve të komitetit,
- Ministrisë së Administrimit dhe pushtetit Lokal,
- Kryetarit të Komunës z. Bexhet Xheladini,
- Drejtoratit për Financa, Ekonomi e Zhvillim të Komunës së Dragashit,
- Arkivit.

**KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH**

01 Nr. 060/01-30942-21/3

Dt. 30.12.2021

**Kryesuesi i Kuvendit :**

**Uran Halimi**

